



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 7, Datë 23.03.2015

PËR

TRAJTIMIN E DISA KËRKESAVE PËR LEJE ZHVILLIMI/NDËRTIMI, TË DEPOZITUARA PRANË BASHKISË TIRANË PËRPARA HYRJES NË FUQI TË VENDIMIT NR. 1, DATË 22.08.2014 TË KKT "PËR HARMONIZIMIN E INSTRUMENTAVE TË PLANIFIKIMIT VENDOR NË FUNKSION TË NDARJES SË RE ADMINISTRATIVO – TERRITORIALE"

Në mbështetje të neneve 9 dhe 27 të Ligjit nr.107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", si dhe Vendimit nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave "Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit", pikës 8 të Vendimit Nr.1, datë 22.08.2014 të KKT-së "Për harmonizimin e Instrumenteve të Planifikimit Vendor në funksion të ndarjes së re administrativo - territoriale", me propozimin e Ministrit të Zhvillimit Urban (shkresa nr. 5067/3 prot, datë 15.12.2014) dhe Bashkisë Tiranë (shkresa nr. 14971/1 prot, datë 10.12.2014), Këshilli Kombëtar i Territorit,

V E N D O S I:

1. **Shqyrtimin e përputhshmërisë me instrumentet e planifikimit në fuqi, të 30 kërkesave për leje zhvillimi/ndërtimi të depozituara pranë Bashkisë Tiranë, të cilat në momentin e miratimit të Vendimit nr.1, datë 22.08.2014 "Për harmonizimin e instrumenteve të planifikimit vendor në funksion të ndarjes së re administrative-territoriale", ishin në proces shqyrtimi në themel, sipas Listës 1 bashkëlidhur këtij vendimi.**
2. **Konfirmimin e përputhshmërisë së 6 kërkesave për leje zhvillimi/ ndërtimi, të cilat rezultojnë të përputhshme me instrumentet e planifikimit në fuqi, sipas Listës 2 bashkëlidhur këtij vendimi.**
3. **Shtyrjen për shqyrtim të mëvonshëm të 21 kërkesave për leje zhvillimi/ndërtimi, të cilat duhet të modifikohen në përputhje me përcaktimet e instrumentit të planifikimit në fuqi dhe të depozitohen përsëri për shqyrtim në KKT, sipas Listës 3 bashkëlidhur këtij vendimi.**
4. **Refuzimin përfundimtar të 3 kërkesave për leje zhvillimi/ndërtimi, të cilat kanë rezultuar të papërputhshme me instrumentet e planifikimit në fuqi, sipas Listës 4 bashkëlidhur këtij vendimi.**



5. Lejtimi e Bashkisë Tiranë për të vijuar me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje zhvillimi/ndërtimi të parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi dhe sipas Listës 2 bashkëlidhur tij, duke u bazuar edhe në vendimin nr.8, datë 07.11.2014, i KKT "Për miratimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi".
6. Ngarkohet Bashkia Tiranë për zbatimin e pikës 3 të këtij vendimi dhe për njoftimin e subjekteve kërkuese, sipas Listës 3 bashkëlidhur tij.
7. Ngarkohet Bashkia Tiranë për zbatimin e pikës 4 të këtij vendimi dhe për njoftimin e subjekteve kërkuese, sipas Listës 4 bashkëlidhur tij.
8. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA

Adelina Greca



DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT